Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër:01-329
Datë:30.08.2017

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr. 03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 25.08.2017 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet Bau Academy në Prishtinë me adresë Rruga Calabria, Veternik, D4 Hyrja B, për periudhën 25.08.2017 deri 25.08.2020 me kualifikimet:

   1.1. Instalues elektrik, Niveli IV sipas KKK me 360 kredi të AAP.
   1.2. Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit, Niveli IV sipas KKK me 410 kredi të AAP.
   1.3. Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit, Niveli IV sipas KKK me 326 kredi të AAP.
   1.4. Metalpunues, Niveli IV sipas KKK me 410 kredi të AAP.

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për kualifikimet:

   Instalues elektrik

   2.1. Harmonizimi i Kornizës Bërthamë të kurrikulit, me të gjitha modulet e përshkruara konform kërkesave të KKK dhe Standardit të Profesionit për klasën e XI dhe XII.

   2.2. Kriteri hyrës në kualifikim dhe i kalueshmërisë të jetë në pajtueshmëri me kornizën Ligjore të MASHT.

   2.3. Trajnimi i stafit mësimdhënës në didaktik profesionale dhe pedagogji.

   2.4. Hartimi i testeve të vlerësimit për pjesën teorike dhe praktike.

   2.5. Panelet për punë praktike të furnizohen me energji elektrike në mënyrë të sigurt dhe të vendosen çelësat diferencial për secilin panel.

   2.6. Të hartohen ose të merren paketa mësimore për modulet profesionale të cilat bazohen në standard dhe në kurrikul.

Instalues i ngrohjes dhe klimatizimit

2.1. Harmonizimi i kurrikulit për Instalues i Ngrohjes dhe Klimatizimit me Kornizën e re të Kurrikulës së Kosovës dhe Kurrikulën bërthamë për klasën XI dhe XII.

2.2. Kriteri hyrës në kualifikim dhe i kalueshmërisë të jetë në pajtueshmëri me kornizën Ligjore të MASHT.

2.3. Trajnimi i stafit mësimdhënës në didaktik profesionale dhe pedagogji.

2.4. Kriteri i kalueshmërisë të jetë më i madh se sa 50 % për të dy vlerësimet pjesën teorike dhe pjesën praktike.

2.5. Duhet shtuar edhe moduli i - Testimit të Rrjetit.

2.6. Hartimi i testeve të vlerësimit për pjesën teorike dhe praktike.

2.7. Të hartohen ose të merren paketa mësimore për modulet profesionale të cilat bazohen në standard dhe në kurrikul.

2.8. Përgatitja e manualit për nxënës pjesëmarrës në program.

Instalues i ujësjellësit dhe kanalizimit

2.1. Harmonizimi i kurrikulit për kualifikimin Instalues i Ujësjellësit dhe kanalizimit me Kornizën e Re të Kurrikulës së Kosovës dhe Kërrikullin bërthamë për klasën e XI dhe klasën e XII.

2.2. Harmonizimi i politikave dhe procedurave në një dokument të përbashkët.

2.3. Harmonizimi i rregulloreve të institucionit në një dokument të përbashkët.

2.4. Përgatitja e manualit për nxënës pjesëmarrës në program.

2.5. Përgatitja e planit për trajnimin e stafit.

2.6. Zhvillimi i formularëve të ndryshëm si: për vëzhgimin e mësimdhënësve, për raportim të incidenteve, për identifikimin e nevojave për trajnim të stafit.

2.7. Përgatitja e planit për vlerësim dhe verifikim të brendshëm.

2.8. Hartimi i testeve për vlerësim teorik dhe praktik.

Metalpunues

2.1. Harmonizimi i Kornizës Bërthamë të kurrikulit, me të gjitha modulet e përshkruara konform kërkesave të KKK dhe Standardit të Profesionit për klasën e XI dhe XII.

2.2. Kriteri hyrës në kualifikim dhe i kalueshmërisë të jetë në pajtueshmëri me kornizën Ligjore të MASHT.

2.3. Referencat mësimore për klasën 10.

2.4. Trajnimi i stafit mësimdhënës në didaktik profesionale dhe pedagogji.

2.5. Kriteri i kalueshmërisë të jetë më i madh se sa 50 % për të dy vlerësimet pjesën teorike dhe pjesën praktike

2.6. Hartimi i testeve të vlerësimit për pjesën teorike dhe praktike.

2.7. Të hartohen materialet mësimore dhe mbështetëse për modulet mësimore sipas rezultateve mësimore dhe që përmbushin kriteret e vlerësimit.

2.8. Referencat dhe materialet mësimore për klasat 11 dhe 12.

3. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datat 01.09.2017 dhe 01.09.2018 sipas raporteve të jashtme vlerësuese për secilin kualifikim. Në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

A r s y e t i m

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e institucionit i cili ofron dhe/ose vlerëson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në diapozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:
Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

5. Vendimi u dërgohet:
   - BAU Academy;
   - AKK.

Bedri Xhafa

Kryetari i KD së AKK-së